



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 19 dhe 40 të Statutit dhe të Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.mars 2001, konform Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.05.2006, mori

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E NGASTRËS KADASTRALE NR. 4921/2, NË RRUGËN “NAZIM GAFURRI” NË PRISHTINË, ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

I

Shpallet me interes të përgjithshëm ngastra kadastrale nr. 4921/2, me sipërfaqe 9m², në rrugën “Nazim Gafurri” pa nr. në Prishtinë, pronë e qytetares Fatima Baqevaci

II

Pronares, nga neni I i këtij Vendimi, do t’i kompensohet prona pas arritjes së marrëveshjes për lokacionin e mundshëm.

III

Drejtorati i Kulturës dhe i Gjinisë i Komunës së Prishtinës, do t’i kryejë veprimet e tij procedurale nga përgjegjësia e tij e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

IV

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës

V

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 952-208, më 04.05.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri